

URDHËR
Nr. 413, datë 24.9.2021

**PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19,
PËR PERSONELIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE STUDENTËT**

(ndryshuar me urdhrin nr. 413/1, datë 27.9.2021)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, të Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit të datës 29.8.2021, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614 prot., datë 30.8.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019

URDHËROJ:

1. Të gjithë personat që rrezikohen dhe përbëjnë rrezik për të tjerët, për të penguar përhapjen e sëmundjeve infektive përmëshin detyrimet e përcaktuara në nenin 18, pika 7, germa “a/ii”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar.
2. Personeli i institucioneve arsimore dhe studentët, si një ndër kategoritë e përfshira në pikën 1, të këtij urdhri, duhet të depozitojnë pranë qendrës së punës dhe studentët pranë zyrave të përcaktuara nga IAL-të përkatëse, Certifikatën e Vaksinimit COVID-19 nga *e-Albania* apo kartën e vaksinimit.
3. Për punonjësit e institucioneve arsimore që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit, do të kërkohet paraqitja, çdo javë, e testit PCR, të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2, duke filluar nga data 27.9.2021.
4. *Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021.*
5. Institucionet arsimore të identifikojnë personelin e institucionit arsimor dhe studentët që kanë depozituar Certifikatën e Vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit dhe të raportojnë pranë Institutit të Shëndetit Publik informacion mujor mbi identifikimin e kryer.
6. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara në këtë urdhër bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.
7. Instituti i Shëndetit Publik të marrë masat dhe të monitorojë mbulimin vaksinal të grupet e përmendura në pikën 2 të këtij urdhri dhe të raportojë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
8. Ngarkohet Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik të bashkëpunojnë me institucionet e arsimit të lartë, për zbatimin e këtij urdhri.
9. Ky urdhër i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu